

Auto 27.07.2018

U 104



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 8025 Prot.

Tiranë, më 25.07. 2018

**URDHËR**

**NR. 449, DATË 25.07. 2018**

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT “MASTER  
PROFESIONAL” NË “FIZIOTERAPI” NË KOLEGJIN UNIVERSITAR  
“REALD”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, 72 dhe 75 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Fizioterapi”, që realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Fizioterapi”, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, të Kolegjit Universitar “Reald”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Fizioterapi”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Kolegji Universitar “Reald”, t’i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin “Kolegji Universitar “Reald””.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit

dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Reald”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikollë

